



Republika e Kosovës – Republika Kosova  
Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa  
Izborni Panel za Žalbe i Predstavke

ZL.Anr.566/2017

**Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtresa (PZAP)**, në panelin e përbërë nga gjyqtarët: Gyltene Sylejmani kryesues, Ymer Hoxha dhe Afijete Sada-Gllogjani anëtarë, me pjesëmarrjen e Zyrtarit Ligjorë Ardian Maxhuni, duke vendosur përkitazi me ankesën e Lutfi Haxhiut, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, paraqitur kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtar të publikuar nga Komisioni Qendror i Zgjedhjeve (KQZ) me datë 08.11.2017, për Zgjedhjet Lokale të mbajtura më datë 22.10.2017, në seancën e panelit të mbajtur me 10.11.2017, mori këtë:

### V E N D I M

**REFUZOHET** si e pabazuar ankesa parashtruara nga Lutfi Haxhiut, kandidat për anëtar të Kuvendit Komunal, nga subjekti politik PDK, me seli në Prishtinë, dega në Podujevë, me shenjën ZL.Anr.566/2017 e datës 09.11.2017, të parashtruar kundër vendimit për shpalljen e rezultateve përfundimtare nga KQZ më datë 08.11.2017, për shkak të mungesës së votave, për Zgjedhjet Lokale të datës 22.10.2017.

### A r s y e t i m

Paneli i PZAP-it me datën 09.11.2017, në ora 12:00, ka pranuar një ankesë nga Lutfi Haxhiu, kandidatë për anëtarë të Kuvendit Komunal në Podujevë, nga radhët e subjektit politik Lidhja Demokratike e Kosovës (LDK), me të cilën thekson se në këto Qendra të Votimit QV nr. 1801E/01R, 02R, 03R, 04R, 05D, 1801X/01R, 02R, 03R, 04D, 1802E/01R,02R,03R,04R,05D, 1803E/01R, 02R, 03D, 1805E/01D, 1807E/01R, 02R,M 03D, 1812E/01R, 02R, 03D, 1813E/01R,02D, 1814E/01R, 02R, 03D, 1815E/01,02R, 03D, 1819E/01R, 02R, 03D, 1820E/01R, 02R, 03D, 1821E/01D, 1822E/01R, 02D, 1824E/01R, 02R, 03R, 04R, 05R, 06R, 07R, 08R, 09R, 10R, 11R, 12R, 13R, 14D, 1825E/01D, 1827E/01R, 02R, 03D, 1829E/01R, 02D, 1830E/01R, 02D, 1831E/01R, 02D, 1832E/01R, 02D, 1833E/ 01R,02D dhe 1837E/01R, 02D.

Paneli, pasi që shqyrtoj të gjitha shkresat e lëndës në kuptim të nenit 117 par. 2 të LZP-së, gjeti se:

### **Ankesa është e pa bazuar**

Paneli i PZAP-it, vlerëson se parashtruesi i ankesës në mbështetje të pretendimeve ankimore në ankesë, nuk ka ofruar asnjë dëshmi të qartë për të vërtetuar pretendimet në ankesë, të paraparë me dispozitën e nenit 117 par. 3 të LZP-së ku është përcaktuar: “*se vendosja për ankesa dhe apele nga PZAP-i mbështetet në dëshmi të qarta dhe bindëse*”. Paneli gjatë

vendosjes së ankesës gjeti se pretendimet ankimore të ankuesit nuk janë të bazuara në fakte andaj si të tillë ankesën e refuzoj.

Kjo për faktin se pala ankuese nuk ka ofruar asnjë provë bindëse dhe nuk e ka specifikuar qartë se sa vota i mungojnë në secilën Qendër të Votimit për të vërtetuar pretendimet ankimore lidhur me keqpërdorimin e votave në ditën e votimit. Më tej në qendrat e votimeve të lartë cekura, ashtu si është përcaktuar në nenin 5.7 pika (b) dhe (c) të Rregullës dhe Procedurave të PZAP-së nr.02/2015, ku përcaktohet: *”Të gjitha ankesat duhet të kenë së paku këto informacione: një përshkrim të hollësishëm, duke përfshirë datën kohën dhe vendin e shkëljes së pretenduar; hollësi rreth çfarëdo dëshmie dhe kopje të çfarëdo dokumentacioni relevant apo dëshmi të tjera në posedim të ankuesit”*.

Andaj, nisur nga arsyet e theksuara më lartë në kuptim të dispozitave të nenit 117 dhe 118 par. 1 të LZP-së, Paneli i PZAP-it, vendosi si në dispozitiv të këtij vendimi.

### **Paneli Zgjedhor për Ankesa dhe Parashtrës**

ZL. Anr.566/2017 më datën 10.11.2017.



**Kryesuesi i Panelit**  
Gyltene Sylejmani

**Këshillë Juridike:** Kundër këtij vendimi është e lejuar ankesa sipas nenit 118 par. 4 të LZP-së, në Gjykatën Supreme të Kosovës, brenda njëzetekatër (24) orëve nga momenti i marrjes-pranimi të këtij vendimi.